

VENDIM
Nr. 887, datë 4.11.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË GODINËS SË BASHKISË KURBIN E CAKTIMIT E BASHKISË
KURBIN SI NJËSI ZBATUESE**

(Ndryshuar me vendimin nr. 146, datë 11.3.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 382 954 978.28 (treqind e tetëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë njëzet e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të godinës së Bashkisë Kurbin, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2020, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 296 969 254.28 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër pikë njëzet e tetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga grantet e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020;

b) Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 85 985 724 (tetëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

2. Bashkia Kurbin caktohet si njësi zbatuese për rindërtimin e godinës së Bashkisë Kurbin, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin.

3. Shfuqizuar.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim”, të buxhetit të shtetit.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe